

UDHËZIM
Nr. 1, datë 30.1.2006

**PER HAPJEN E KUTIVE TE VOTIMIT, KUTIVE TË MATERIALEVE ZGJEDHORE DHE
ADMINISTRIMIN E DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR TË GJENDUR NË TO, PAS
PËRFUNDIMIT TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të neneve 29, pika 1, dhe 180 të ligjit nr. 9087, datë 19.06.2003 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr. 9297, datë 21.10.2004 dhe ligjin 9341, datë 10.01.2005,

U D H Ë Z O N:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim përcakton procedurat që ndiqen për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore pas përfundimit të procesit zgjedhor, procedurat për seleksionimin, kategorizimin dhe arkivimin e dokumentacionit zgjedhor, magazinimin dhe asgjësimin e materialeve të gjendura në kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore.

Neni 2
Hapja e kutive të votimit

Hapja e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore bëhet me vendim të KQZ-së.

Neni 3
Rendi i hapjes së kutive të votimit

Hapja e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore bëhet veçmas për çdo njësi zgjedhore.

Neni 4
Komisioni për hapjen e kutive të votimit (KHKV)

Komisioni për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore është përgjegjës për organizimin e procesit për hapjen e kutive të votimit dhe përzgjedhjen e dokumentacionit.

Neni 5
Përbërja e komisionit për hapjen e kutive të votimit

KHKV përbëhet nga:

- | | |
|---|----------|
| - Sekretari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve - | Kryetar, |
| - Drejtori i Drejtorisë së Logjistikës - | Anëtar, |
| - Drejtori i Drejtorisë Juridike - | Anëtar, |
| - Përgjegjësi i Zyrës së Regjistrimit të Akteve
dhe Dokumentacionit- | Anëtar, |
| - Inspektori i Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore - | Anëtar. |

Neni 6
Llojet e dokumentacionit dhe materialet zgjedhore

- a) Materiali që nxirret nga kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore përbëhet nga:
- dokumentacioni për arkivim;
 - materialet që mund të ripërdoren;
 - materialet që do të asgjësohen.
- b) Dokumentacioni për arkivim që dërgohet në Arkivin Qendror të Shtetit përfshin:
- Librin e protokollit;

- Fletore e vendimeve tip të KQV-së;
- Regjistër i posaçëm i zgjedhësve;
- Lista e zgjedhësve.

c) Në materialet që mund të ripërdoren përfshihen:

- Kod Zgjedhor;
- Kuti votimi;
- Tampon vule;
- Llampë UV;
- Bojë matrikulluese;
- Materiale të tjera.

d) Në materialet që do të asgjësohen përfshihen:

- fletët e votimit;
- kundërfletët e fletëve të votimit;
- gjithë artikujt e tjerë të paklasifikuar në pikat b dhe c të këtij neni.

e) Sekretari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kujdeset për dorëzimin e materialeve që ruhen, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit.

Neni 7

Organizimi i punës

a) Drejtoria e Logjistikës Zgjedhore organizon grupet e punës (GP) dhe është përgjegjëse për realizimin e procesit të hapjes së kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore.

b) Grupi i punës hap kutitë e votimit, kutitë e materialeve zgjedhore dhe grupon veçmas:

- dokumentacionin për arkivim;
- materialet që mund të ripërdoren;
- materialet që do të asgjësohen.

c) Në përfundim të hapjes së kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të një njësie zgjedhore, GP harton një procesverbal sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Ky procesverbal nënshkruhet nga supervizori i GP-së.

d) Procesverbalet e hartuara për çdo njësi zgjedhore ruhen në KQZ, në përputhje me rregullat për administrimin e dokumenteve.

Neni 8

Përpunimi i dokumentacionit dhe materialeve zgjedhore

a) Dokumentacioni për arkivim, sipas përcaktimit të nenit 5 pika b dërgohet në Arkivin Qendror të Shtetit.

b) Materialet që mund të ripërdoren, magazinohen pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

c) Fletët e votimi dhe kundërfletët digjen.

Neni 9

Asgjësimi i materialeve

Asgjësimi i materialeve sipas nenit 7 pika c të këtij udhëzimi bëhet me procesverbal, nga KHKV.

Neni 10

Raportimi

Në përfundim të procesit të hapjes së kutive të votimit, KHKV i paraqet KQZ-së një raport.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI
Ilirjan Celibashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Lidhja 1

Për: <u>Verifikimin e dokumentacionit si dhe bazës materiale të ripërdorshme të gjetur brenda kutive të materialeve zgjedhore apo kutive të votimit të njësisë zgjedhore</u>		Procesverbal PV Nr: KQZ/DL/06/ _____ Datë: ____/____/____	
Baza Ligjore: Neni 180/6 i ligjit nr.9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar		<i>Pas hapjes së kutive të materialeve zgjedhore dhe kutive të votimit të njësisë zgjedhore, u gjet dhe e përzgjedh dokumentacioni dhe materialet e</i>	
NJËSIA ZGJEDHORE _____		QARKU _____	NUMRI I QENDRAVE TË VOTIMIT _____
Dokumentacion:			
r.	Emërtimi	Sasia	Vërejtje
.	Libër Protokolli		
.	Procesverbal i Konstatimit		
.	Fletore e vendimeve tip të KQV-së		
.	Lista e zgjedhesve e QV-se dhe/ose Regjistër i Posaçëm i Zgjedhësve		
.			
Baze materiale e ripërdorshme:			
r.	Emërtimi	Sasia	Vërejtje
.	Kod Zgjedhor		
.	Kuti votimi		
.	Kuti e materialeve zgjedhore		
.	Tampon vule		
.	Llampë UV		
.	Bojë matrikulluese		
.	Vizore		
.			
.			

Vërtetoi për grupin e punës: Emër/Mbiemër: _____ Firma: _____	Sigloi: Për Drejtorinë e Logjistikës (Emër, Mbiemër, Firmë)
--	---